

SHOQËRIA "INDUSTRIALIMPEKS" SH.A
ASAMBLEJA E AKSIONARËVE

VENDIM
Nr.2, datë 27.07.2011

Sot më datë 27.07.2011 në adresën Rr "Ismail Qemali", pall. Abissnet, Tiranë, u mbajt mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të Shoqërisë "INDUSTRIALIMPEKS" Sh.a.

Në bazë të nenit 144 dhe 145 te ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare "INDUSTRIALIMPEKS" Sh.a mbledhja konsiderohet e rregullt.

Aksionarët e pranishëm, pasi u njohën me rendin e ditës dhe shqyrtyuan dokumentacionin përkatës,

VENDOSËN:

- 1- Të miratojnë statutin e ri të shoqërisë "INDUSTRIALIMPEKS" Sh.a në bazë të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare".
- 2- Ky vendim hyn ne fuqi sot, me datë 27.07.2011

ASAMBLEJA E AKSIONAREVE

Shoqëria "2K GROUP" Sh.p.k
Administratore
Brixhilda KOKËDHIMA

MINSITRIA E EKONOMISE, TREGETISE DHE ENERGJITIKES
Perfaqesuar me autorizimin Nr.4956/I Prot, date 21.07.2011
nga Znj.Valentina Murrashi



**STATUTI
SHOQËRISË AKSIONARE "INDUSTRIALIMPEKS" SILA**

Duke qënë se shoqëria "INDUSTRIALIMPEKS" SILA, është një shoqëri e cila ushtron aktivitetin e saj në përputhje të plotë me kuadrin legjislativ në fuqi në Republikën e Shqipërisë;

duke qënë se gjatë periudhës së veprimtarisë shoqëria ka ndryshuar disa herë statutin e saj në disa pjesë të tij përfshirë kapitalin, selinë, objektin e veprimtarisë;

duke qënë se kjo shoqëri ushtron veprimtarinë e saj në përputhje të plotë me kuadrin legjislativ në fuqi në Republikën e Shqipërisë;

duke qënë se Ligji nr.9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", në ninen 230 paragrafi 2, parashikon detyrimin për të tëra shoqëritë tregtare, të themeluara përparrë hyrjes së tij në fuqi, që brenda datës 22 maj 2011 të përshtasin organizimin dhe funksionimin e tyre me ligjin në fjalë;

duke qënë se shoqëria "INDUSTRIALIMPEKS" SH.A është themeluar që më date 22.06.1999, pra, përparrë hyrjes në fuqi të ligjit të sipërpërmendur, dhe si rrjedhojë i nënshtrohet detyrimit të mësipërm;

duke qënë se është në interesin maksimal të shoqërisë "INDUSTRIALIMPEKS" SH.A që të përbushë këtë detyrim sa më parë që të jetë e mundur;

duke qënë se miratimi i statutit të ri të shoqërisë i cili do të zëvendësojë statutin aktual është mënyra më efikase, e drejtë, e saktë dhe e plotë për ta vendosur shoqërinë "INDUSTRIALIMPEKS" SH.A në kushtet e ligjshmërisë së plotë në raport me ligjin e sipërpërmendur;

Aksionarët e shoqërisë, miratojnë statutin e ri të shoqërisë "INDUSTRIALIMPEKS" SH.A me përbajtje si vijon.

TË PËRGJITHSHME

Në këtë statut:

- "Ligj" është Ligji Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare";
- "Statuti" është ky statut i shoqërisë;
- "Aksione" janë njësítë bazë të ndarjes së kapitalit të shoqërisë, të cilët iu japin zotëruesve të tyre tagër për të ushtruar në Asamblenë e Përgjithshme të drejtat e aksionarit dhe për të përfituar pjesë të fitimeve dhe të shpërndarjes së pasurive të mbetur pas likuidimit, në raport të drejtë me pjesën e kapitalit që aksionet e tyre përfaqësojnë. Aksionet janë vetëm aksione të zakonshme, por, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, dhë pa qënë i nevojshëm amendimi

**STATUTI
SHOQËRISË AKSIONARE "INDUSTRIALIMPEKS" SH.A**

-
- i Statutit, mund të krijohen kategori të tjera aksionesh sipas nevojave të shoqërisë;
- "Aksionarë" janë personat emrat e të cilëve janë regjistruar në regjistrin e aksioneve të shoqërisë si zotërues të aksioneve.
 - "Registri i Aksioneve" është registri i posaçëm, i mbajtur nga shoqëria ku regjistrohen të dhënat vijuese për aksionet dhe për secilin aksionar: (i) lloji i aksioneve; (ii) data e emetimit të tyre; (iii) për aksionarët persona fizikë, emri, mbiemri, adresa e banimit, dhe numri i dokumentit të identifikimit; (iv) për aksionarët persona juridikë, emri siç është regjistruar në regjistrin tregtar, adresa e plotë e sëllisë, dhe Numri Unik i Identifikimit të Subjektit (në vijim referuar si "NUIS"); (v) vlera nominale e aksionit; (vi) numri i aksioneve të zotëruara; (vii) përparësitë e aksioneve, nëse ka; (viii) numri total i aksioneve të emetuara nga shoqëria; (ix) pjesa e kapitalit të shoqërisë së zotëruar nga secili aksionar; dhe (x) data e fitimit të statusit të aksionarit.
 - "ditë të plota" në lidhje me periudhën e një njoftimi është periudha që nuk e përfshin ditën kur është dhënë ose kur konsiderohet se është dhënë njoftimi dhe ditën për të cilën është dhënë ose hyn në fuqi njoftimi.

Titull I

**THEMELIMI, EMËRTIMI, REGJISTRIMI DHE PERSONALITETI
JURIDIK**

Neni 1

Data e themelimit, Emërtimi

- (1) Shoqëria "INDUSTRIALIMPEKS" SH.A është themeluar më datë 22 Qershor 1999.
- (2) Ky statut i shoqërisë nuk shuan dhe as ndryshon statusin, të drejtat dhe/ose detyrimet e shoqërisë të themeluar dhe regjistruar si më lart.
- (3) Ky statut nuk krijon një subjekt të ri të së drejtës, nuk ndryshon marrëdhëniet në të cilat "INDUSTRIALIMPEKS" SH.A është tashmë palë, dhe në çdo rast nuk ndikon në debitë dhe/ose kreditë e shoqërisë "INDUSTRIALIMPEKS" SH.A
- (4) Ky statut miratohet me qëllim përshtatjen e organizimit dhe funksionimit të shoqërisë "INDUSTRIALIMPEKS" SH.A me Ligjin Tregtar.



2

**STATUTI
SHOQËRISË AKSIONARE “INDUSTRIALIMPEKS” SH.A**

Neni 2

Personaliteti juridik

- (1) Shoqëria është person juridik shqiptar.
- (2) Shoqëria gëzon të drejta si person juridik shqiptar, që prej datës në të cilën është themeluar dhe regjistruar në rregjistrin tregëtar, pa u kushtëzuar këto të drejta nga miratimi i këtij statuti.
- (3) Shoqëria e ushtron aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara në dokumentet themeluese (Akt Themelimi dhe Statut).

Neni 3

Emri i shoqërisë

- (1) Emri i shoqërisë është “INDUSTRIALIMPEKS” SH.A.
- (2) Shoqëria e ushtron veprimtarinë nën emrin e saj sipas paragrafit I të këtij neni.
- (3) Ndryshimi i aksionarëve dhe/ose transferimi i veprimitarisë nuk sjell ndryshimin e emrit dhe/ose të emërtimit të shoqërisë, me përjashtim të rasteve kur vendoset shprehimi i ndryshtë nga Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë. Gjithashtu, nëse emri dhe/ose emërtimi i shoqërisë vijon të përdoret, titullari i ri i veprimitarisë trashëgon të gjitha detyrimet tregtare të titullarit të mëparshëm.

Neni 4

Forma

- (1) Shoqëria është një shoqëri aksionare me ofertë private.
- (2) Shoqëria mund ta ndryshojë formën e saj në shoqëri me përgjegjësi të kufizuar ose në shoqëri aksionare me ofertë publike nëpërmjet procedurës së shndërrimit.

Neni 5

Objekti

Shoqëria aksionare do të zhvillojë aktivitet me objektin e mëposhtëm:

- Importimi dhe eksportimi i artikujve të ndryshem ushqimore, industriale, bujqësore, elektrike, elektronike, elektro-shtëpiake, konfeksione etje;
- Tregëtimi dhe shitja e artikujve të ndryshëm ushqimore, industrialë, bujqësore, elektrike, elektro-shtëpiake, konfeksione etje;

3

**STATUTI
SHOQËRISË AKSIONARE "INDUSTRIALIMPEKS" S.H.A**

-
- Transporti nëpërmjet rrugëve tokësore, detare dhe ajrore etje, i mallrave të sipërpermendur për llogari të vetë shoqërisë si dhe shoqërive dhe personave të tjerë juridikë privatë dhe shtetërorë;
 - Shërbime komisionere për të gjitha operacionet tregtare që do të zhvillohen brënda dhe jashtë vendit në emër dhe për llogari të vetë shoqërisë si edhe të shoqërivë dhe personave të tjerë juridikë privatë dhe shtetërorë brënda dhe jashtë vendit;
 - Kryerja e rolit të agjentit dhe magazinës doganore, përfaqësuesit dhe distributorit(shpërndarësit) të autorizuar ose ekskluziv sipas rastit.
 - Shoqëria brënda caqeve të parashikuara nga legjislacioni ne fuqi do të kryejë edo operacion tregtar dhe finansiar që lidhet drejtperdrejt ose terthorazi me objektin e saj. Kjo perfshin: Hapjen e veprimtarive dhe krijimin e shoqërive të reja si dhe pjesëmarrjen në kapitalin e shoqërive të tjera brënda dhe jashtë vendit.

Neni 6

Kohëzgjatja

- (1) Shoqëria do ta ushtrojë veprimtarinë e saj pa afat.

Neni 7

Selia e shoqërisë

- (1) Shoqëria aksionare e ka selinë të rregjistruar në adresën; Rr. "5 Maji", ish-Nderrmarja kimike, Tiranë, Shqipëri.

Titulli II

KAPITALI AKSIONAR

**Neni 8
Kapitali themeltar**

- (1) Kapitali i shoqërisë është i ndarë në aksione.
- (2) Kapitali i shoqërisë është në vleren 6.900.000 (gjashtë milion e nëntëqind mijë) lekë.
- (3) Çdo aksion ka vlerë nominale prej 1.000 (njëmijë) lekësh.
- (4) Kapitali i shoqerise perbehet nga 6.900 (gjashte mijë e nenteqind) aksione.
- (5) Aksionari shoqeria "2K GROUP" Sh.p.k zoteron 51% te aksioneve.
- (6) Aksionari Ministria e Ekonomise Tregetise dhe Energjikës zoteron 49% te aksioneve
- (7) Transferimi i aksioneve dhe i të drejtave të lidhura me to sjell pasoja juridike

STATUT I
SHOQËRISË AKSIONARE “INDUSTRIALIMPEKS” SH.A

-
- vetëm pasi akti i transferimit regjistrohet pranë QKR-së.
- (8) Ndalohet emetimi dhe/ose ofrimi për nënshkrim i aksioneve me çmim nën vlerën e tyre nominale.
- (9) Shoqëria mund të emetojë e të ofrojë për nënshkrim aksione me çmim më të lartë se vlera e tyre nominale.
- (10) Shoqëria nuk mund të nënshkruajë aksionet e veta.
- (11) Shoqëria nuk mund të ushtrojë, për aksionet e veta, të drejtat që rrjedhin nga zotërimi i tyre.

Neni 9

Llojet e aksioneve, mënyra e fitimit te aksioneve, të drejtat që lidhen me to

- (1) Aksionet janë aksione të zakonshme.
- (2) Aksionet mund të fitohen dhe/ose transferohen përmes:
- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
 - b) kontratacave të përshtatshme për kalimin e pronësisë;
 - c) trashëgimisë; dhe/ose
 - ç) çdo mënyre tjetër të ligjshme.
- (3) Të drejtat e aksioneve të fituara si më sipër nuk mund të ushtrohen ndaj asnjë personi apo ndaj shoqërisë, përpara se veprimi juridik me të cilin aksionet janë fituar të jetë regjistruar në Regjistrin e Aksioneve, që mban shoqëria.
- (4) Kalimi i aksioneve me kontratë është i vlefshëm vetëm nëse bëhet me akt notarial.
- (5) Çdo aksion i jep aksionarit të drejta vote në raport proporcional me pjesën e kapitalit që përfaqëson aksioni, të drejta e përsitimit të dividendifit si dhe të drejta të tjera të parashikuara në ligjin tregtar në fuqi.

Neni 10

Regjistri i aksioneve

Shoqëria “INDUSTRIALIMPEKS” SH.A mban regjistrin e aksioneve ku regjistrohen të dhënat që lidhen me aksionet. Administratori i emëruar i shoqërisë është përgjegjës për ngritjen e regjistrimit të aksioneve dhe për të siguruar që ai të funksionojë në përpunje me Nenin 119 të Ligjit tregtar në fuqi.



5

STATUT I
SHOQËRISË AKSIONARE "INDUSTRIALIMPEKS" SH.A

Neni 11

Transferimi i aksioneve

1. Kalimi i aksioneve sipas mënyrave të prashikuara në ligjin tregtar në fuqi eshte lirisht i transferueshem dhe nuk kushtëzohet nga e drejta e parablerjes në favor të një aksionari tjeter apo nga pelqimi paraprak i organeve drejtuese te shoqerise.
2. Transferimi i aksioneve shteterore ne rast privatizimi do te kryhet ne baze te legjislacionit ne fuqi per privatizimin.

Neni 12

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit aksionar

- (1) Shoqëria njeh dhe pranon të gjitha format e zmadhimit të kapitalit të parashikuara në ligjin tregtar në fuqi.
- (2) Zvogëlimi i kapitalit do të kryhet në përputhje me disozitat ligjore tregtare në fuqi.
- (3) Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve është organi kompetent për zmadhimin ose zvogëlimi e kapitalit.
- (4) Zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit vendoset me jo më pak se tre të katërtat e votave të aksionarëve, të cilët zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të aksioneve me të drejtë vote.

Titulli III

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Neni 13

Perbërja

Asambleja e Përgjithshme përbhet nga aksionaret e Shoqerise "INDUSTRIALIMPEKS" SH.A e cila ushtron te drejtat e aksionareve per ceshtjet e lidhura me funksionimin e shoqerise sipas Nenit 135 te Ligjit "Per Shoqerite Tregetare" ne fuqi.

6

**STATUTI
SHOQËRISË AKSIONARE "INDUSTRIALIMPEKS" S.H.A**

Neni 14

Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme

- (1) Administratori mund të thërrasi mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme dhe këtë gjë duhet ta bëjë të paktën një herë në vit. Këshilli Mbikëqyrës e thërret mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme sa herë që vlerësohet e nevojshme për interesat e shoqërisë.
- (2) Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret me anë të njoftimi i cili duhet të bëhet të paktën 21 (njëzetënjë) ditë të plota përpara saj.

Neni 15

Punimet e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

- (1) Punimet e mbledhjes nuk fillojnë nëse nuk është i pranishëm kuorumi që kërkon Neni 144 i Ligjit tregtar në fuqi.
- (2) Këshilli Mbikëqyrës cakton një person për të mbajtur procesverbalin e mbledhjes.
- (3) Administratori ose një prej anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës ka të drejtë të marrë pjesë dhe të flasë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme.
- (4) Me pëlqimin e mbledhjes në të cilën është i pranishëm kuorumi, Kryetari mundet (dhe është i detyruar, nëse ia kërkon asambleja), t'i shtyjë punimet e Asamblesë në një ditë tjeter. Kur punimet e Asamblesë janë shtyrë për katërmëdhjetë ditë ose më shumë nga dita kur aksionarët kane vendosur për të shtyrë mbledhjen, duhet dhënë një njoftim prej të paktën shtatë ditësh të plota në të cilin përcaktohet ora dhe vendi i mbledhjes së shtyrë dhe natyra e përgjithshme e pikave të punës që duhen kryer për qëllimin e mbledhjes.
- (5) Vendimet që duhen aprovuar përmes votimit të Asamblesë merren me votë të hapur, nëse, përpara ose gjatë deklarimit të rezultatit, nuk është kërkuar në mënyrë të rregullt një votim i fshehtë. Votimin e fshehtë mund ta kérkojë

1. Kryetari; ose

2. aksionarët që përfaqësojnë të paktën pesë përqind të kapitalit bazë të shoqërisë. Kërkesa e bërë nga një person që ka prokurë votimi nga një aksionar ka të njëjtën vlerë sikur ta bëjë aksionari në fjalë.



7

**STATUTI
SHOQËRISË AKSIONARE "INDUSTRIALIMPEKS" S.H.A**

Neni 16

E drejta e votës

- (1) Çdo askion mbart te drejten e nje vote.

Neni 17

Përfaqësimi në Asamble

- (1) Një aksionar mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme, në bazë të një prokure të posaçme nga një aksionar tjetër apo nga një person i tretë.
- (2) Administratori dhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës nuk mund të veprojnë si përfaqësues të aksionarëve në Asamblenë e Përgjithshme.
- (3) Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.
- (4) Përfaqësuesi i autorizuar është i detyruar të deklarojë çdo fakt apo rrethanë, të tillë që, sipas gjykimit të aksionarit të përfaqësuar, rrezikon të ndikojë në vendimmarrjen e përfaqësuesit për interesa të tjerë të ndryshëm nga ata të aksionarit të përfaqësuar.

Neni 18

Kompetencat e Asamblesë

Asambleja e Përgjithshme është kompetente për marrjen e të gjitha vendimeve sipas nenit 135 të ligjit tregtar në fuqi.

Neni 19

Emërimi i ekspertëve kontabël të autorizuar të pavarur

Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë ose një shoqëri auditimi si auditues të autorizuar të pavarur të shoqërisë. Emërimi i nënshtrohet një vendimi të zakonshëm të Asamblesë:

- (1) Gjatë mandatit të tyre, audituesit ligjor mund të largohen vetëm mbi baza ligjore të arsyeshme.
- (2) Audituesi ligjor ose shoqëria e auditimit i raporton Këshillit Mbikëqyrës për çështjet kyçe që dalin nga auditimi ligjor është, në veçanti, për dobësitë me rëndësi materiale në sistemin e kontrollit të brendshëm në lidhje me procesin e raportimit financiar.

8

Muri

**STATUTI
SHOQËRISË AKSIONARE "INDUSTRIALIMPEKS" SILA**

Titulli IV

ADMINISTRATORËT

Neni 20

Emërimi dhe shkarkimi i Administratorëve

- (1) Afati i qëndrimit në detyrë i Administratorit do të jetë për një periudhë kohore 3 vjeçare.
- (2) Kompetent për emërimin dhe shkarkimin e Administratorëve të shoqërisë do të jetë organi i Këshillit Mbikqyrës.

Neni 21

Kompetencat e Administratorit

- (1) Politikat e biznesit të shoqërisë menaxhohen nga Administratorët të cilët përfaqësojnë shoqërinë dhe mund t'i ushtrojnë kompetencat e shoqërisë sipas dispozitave ligjore tregtare në fuqi.

Neni 22

Shkarkimi dhe largimi i administratorëve

Administratori lironet nga funksioni nëse:

1. pushon së qeni Administrator në bazë të dispozitave të Ligjit përfshirë shkarkimin nga ana e Këshillit Mbikqyrës sipas Nenit 167 paragrafi (2);
2. vuani nga çrregullime mendore;
3. jep dorëheqjen përmes një njoftimi që i bën shoqërisë; ose
4. ka munguar për më shumë se gjashtë muaj radhazi pa lejen e Këshillit Mbikëqyrës në mbledhjet e zhvilluara gjatë kësaj periudhe.

Titulli V

KËSHILLI MBIKËQYRËS

Neni 23

Emërimi i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës. Kohëzgjatja

STATUT I
SHOQËRISË AKSIONARE "INDUSTRIALIMPEKS" SILA

-
- (1) Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës emërohen për një periudhë kohore 3(tre)vjeçare.
- (2) Asambleja e Përgjithshme është organi kompetent për emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës.

Neni 24

Kompetencat e Këshillit Mbikëqyrës dhe të komiteteve të tij

- (1) Këshilli Mbikëqyrës nuk merr pjesë në administrimin e shoqërisë. Këshilli Mbikëqyrës monitoron dhe mbikëqyr vënien në zbatim të politikave nga Administratorët dhe mban nën kontroll përbushjen e kërkesave të Ligjit dhe të Statutit nga ana e tij.
- (2) Këshilli Mbikëqyrës mund t'ia delegojë kompetencat e veta një komiteti që përbëhet nga një ose më shumë anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës. Një delegim i tillë mund të bëhet në varësi të kushteve që mund të vehdosë Këshilli Mbikëqyrës dhe mund të revokohet ose të ndryshohet. Këshilli Mbikëqyrës nuk mund të delegojë asnjerën prej detyrave të cilave u nënshtrohet sipas dispozitave të ligjit.

- (3) Në varësi të parashikimit të lartpërmendur, Këshilli Mbikëqyrës do të krijojë
1. një komitet i cili të përcaktojë standartet për emërimin e Administratorëve nga Asambleja e Përgjithshme;
 2. një komitet i cili të përcaktojë skemën e shpërblimit dhe shpërblimin individual të Administratorëve dhe të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës;
 3. një komitet i cili të auditojë performancën dhe kontabilitetin e shoqërisë.

Komititetet do të përbëhen nga një ose më shumë anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës shumica e të cilëve duhet të janë të pavarur.

- (4) Komitetet e emërimit, shpërblimit dhe auditimit jepin rekomandime të cilat synojnë përgatitjen e vendimeve që i merr vetë Këshilli Mbikëqyrës.

- (5) Në veçanti, komiteti i auditimit:
1. monitoron procesin e raportimit financiar;
 2. monitoron efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe sistemit të menaxhimit të rreziqeve, që ka shoqëria;
 3. monitoron auditimin ligjor të bilanceve vjetore dhe të konsoliduara;

**STATUTI
SHOQËRISË AKSIONARE “INDUSTRIALIMPEKS” SILA**

4. shqyrtan dhe monitoron pavarësinë e audituesve ligjor ose të shoqërisë audituese dhe, në veçanti, ofrimin e shërbimeve të tjera shtesë për subjektin e audituar.

Neni 25

Shkarkimi dhe largimi i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës

- (1) Një anëtar i Këshillit Mbikëqyrës largohet nëse:
 1. pushon së qeni anëtar i Këshillit Mbikëqyrës në bazë të dispozitiveve të Ligjit përfshirë Nenet 167 paragrafi (4) dhe 157.
 2. hyn në procedurën e paaftësisë paguese;
 3. vuan nga çregullime mendore;
 4. jep dorëheqjen përmes një njoftimi që i bën shoqërisë.
5. ka munguar për më shumë se gjashtë muaj radhazi pa lejen e anëtarëve të tjerë në mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës të mbajtura gjatë kësaj periudhe dhe Asambleja e Përgjithshme, me propozim të Këshillit Mbikëqyrës, vendos ta lirojë nga detyra.

Neni 26

Punimet e mbledhjeve të Këshillit Mbikëqyrës

- (1) Mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës mbahen sa herë e kërkon aktiviteti i shoqërisë, por jo më pak se dy herë në vit, nëse Asambleja e Përgjithshme nuk vendos, me vendim të zakonshëm, për një shpeshtësi tjeter mbledhjeje. Mbledhjen e parë të Këshillit Mbikëqyrës e thërrret Asambleja.
- (2) Kuromi i nevojshëm për fillimin e punimeve të mbledhjeve të Këshillit Mbikëqyrës është më shumë se një e dyta e anëtarëve.
- (3) Këshilli Mbikëqyrës ngarkon njërin prej anëtarëve të vet me detyrën e Kryetarit të mbledhjeve të veta, duke ruajtur të drejtën për ta shkarkuar nga kjo detyrë në çdo kohë. Mbledhja e parë e Këshillit Mbikëqyrës duhet të thirret menjëherë që të caktojë Kryetarin e Këshillit Mbikëqyrës. Kryetari thërrret mbledhjen e Këshillit dhe drejton punimet e çdo mbledhjeje të Këshillit Mbikëqyrës në të cilën është i pranishëm. Këshilli Mbikëqyrës në rradhët e tij cakton edhe një Nënkyetar, i cili kryen të gjitha funksionet e Kryetarit sa herë që ai mungon, ose ne rastet e delegimit të kompetencave me shkrim apo me gojë.
- (4) Vendimet për çështjet që lindin në një mbledhje merren me shumicë votash. Nëse numri i votave është i barabartë, Kryetari ka të drejtën e hedhjes së një vote të dyte.

11

**STATUTI
SHOQËRISË AKSIONARE “INDUSTRIALIMPEKS” SILA**

Neni 27

Kufizime për votimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës

(1) Një anëtar i Këshillit Mbikëqyrës nuk lidh asnjë marrëveshje dhe nuk voton në një mbledhje të Këshillit Mbikëqyrës ose të një komiteti të Këshillit Mbikëqyrës për asnjë vendim që ka lidhje me një çështje në të cilën ka, drejtpërdrejt ose tërthorazi, një interes ose detyrë me rëndësi materiale dhe që bie ose mund të bjerë ndesh me interesat e shoqërisë sipas nenit 13 të Ligjit nëse të gjithë anëtarët e një mbledhjeje të Këshillit Mbikëqyrës nuk kanë rënë dakort:

1. të autorizojnë lidhjen e marrëveshjes nga ana e tij dhe
2. ta autorizojnë të votojë për çështjen në fjalë.

Autorizimi mund të jetë i përgjithshëm ose i posaçëm për një çështje të veçantë.

(2) Një anëtar i Këshillit Mbikëqyrës nuk konsiderohet si pjesëtar i kuorumi të pranishëm në një mbledhje në lidhje me një vendim për të cilin nuk ka të drejtë vote. Për përashtimin e anëtarit nga marrja e vendimit në një mbledhje të tillë zbatohet përkatësisht Neni 148 i Ligjit.

Neni 28

Procesverbalet e Këshillit Mbikëqyrës

Këshilli Mbikëqyrës kujdeset që në libra të posaçëm të mbahen procesverbalet

1. e të gjithë takimeve të bëra nga Këshilli Mbikëqyrës; dhe
2. të të gjitha punimeve të mbledhjeve të Këshillit Mbikëqyrës dhe komiteteve të tij, ku të përfshihen edhe emrat e administratorëve të pranishëm në secilën mbledhje.

Neni 29

Shpërblimi i punës dhe shpenzimet e Administratorëve dhe anëtarëve të

Këshilli Mbikëqyrës

(1) Administratorët dhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës kanë të drejtë të shpërblehen në bazë të skemës së vendosur nga Këshilli Mbikëqyrës dhe të miratuar me vendim të

12

STATUT I
SHOQËRISË AKSIONARE "INDUSTRIALIMPEKS" S.I.A

zakonshëm të Asamblesë së Përgjithshme në përputhje me Nenin 160 paragrafi (1) të Ligjit.

(2) Përfitimet individuale përcaktohen nga Këshilli Mbikëqyrës. Ato duhet të pasqyrojnë në mënyrë adekuatë detyrat e Administratorëve dhe të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës në lidhje me skemën e përmendur në Paragrafin 1 dhe gjendjen financiare të shoqërisë.

Titulli VI

DIVIDENTËT DHE KAPITALIZIMI I FITIMEVE

Neni 30

Dividendët

(1) Shoqëria, me anë të një vendimi që kërkon shumicë të cilësuar, mund të deklarojë dividendë në përputhje me të drejtat përkatëse të aksionarëve.

(2) Me përashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që u lidhen aksioneve, të gjithë dividendët deklarohen dhe paguhën në përputhje me shumat e paguara për aksionet në lidhje me të cilët paguhet dividendi. Të gjithë dividendët përpjesëtohen dhe paguhën në përpjesëtim me shumat e paguara për aksionet gjatë pjesës ose pjesëve të periudhës në lidhje me të cilat paguhet dividendi. Por, nëse aksionet emetohen me kushtin se merr dividend duke filluar nga një datë e caktuar, atëherë aksioni në fjalë e merr dividendin sipas këtij kushti.

Neni 31

Kapitalizimi i fitimeve

Sipas një vendimi të Asamblesë së Përgjithshme që kërkon shumicë të cilësuar dhe duke pasur në konsideratë parimet e vendosura nga Neni 14 i Ligjit, Administratorët mund të vendosin të kapitalizojnë fitimet e pashpërndara të shoqërisë që nuk kërkohen për rezerva ligjore ose kapitale të detyruara.

Titulli VII

PRISHJA E SHOQËRISË DHE NJOFTIMET

Neni 32

Prishja e shoqërisë

13

STATUT I
SHOQËRISË AKSIONARE "INDUSTRIALIMPEKS" S.I.A

Shoqëria prishet në një nga format e parashikuara në ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtarë".

Neni 33

Njoftimet

Njoftimet dërguar organeve të shoqërisë ose aksionarëve kryhen nëpërmjet:

- a) Formës shkresore
- b) Formës elektronike
- c) Nepërmjet gazetes

Neni 34

Të ndryshme


(1) Për çështje që nuk parashikohen dhe rregullohen shprehimisht nga ky statut, gjajnë referim dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

ASAMBLEJA E AKSIONAREVE

1. SHOQËRIA "2K GROUP" Shpk

Administratore

Brixhilda KOKËDHIMA



2. MINISTRIA E EKONOMISE, TREGETISE DHE ENERGJITIKES

Perfaqësuar me autrizimin Nr.4956/I Prot, date 21.07.2011 nga

Znj. Valentina Murrashi



Tiranë më, 27/07/2011

